

# TURGUT ÖZAL

## BULETINI



## PËRMBAJTJA

### Libri “Drejt Evropës”

“Turgut Özal Education ” nënshkruan marrëveshje me Kolegjet CATS, pjesë e Cambridge Education Group Limited “CEG”

#### Klubi i Medias

Drejtorë  
Gleris Bekteshi  
Ahmet Ercanlı

Kryeredaktore  
Imelda Prencë

Redaktorë  
Erjona Sage  
Elda Rrustemi  
Enkelejda Velo  
Ardiana Sallaku

Nxënës  
Rei Korkuti  
Nikol Dalipi  
Meri Berisha  
Ergita Zenelhasanaj  
Stelakea Mërtiri  
Sidrit Hoxha  
Tea Çerenishta  
Engjëllushe Basha  
Vivien Shkodra  
Alenis Ivanaj  
Hera Hadëri  
Enia Xhaferraj  
Suada Xholi  
Sidrit Rrustemi  
Kiara Ollidashi

Fotograf  
Lulëzim Marra

Dizajn  
Dorjan Pitani

### Vizita në Institucione

### Aktivitete të Klubit Shpresa

ADRESA  
Rruga “Bernardin Palja”  
Ndërtesa 15, Hyrja 1  
Njësia Bashkiake Nr.6  
Tiranë – Shqipëri

TEL: +355 42 486-666  
FAX: +355 42 486-666  
info@turgutozal.edu.al





**Konkurse dhe Olimpiada**

**Takime dhe biseda**

**Mësojmë përmes praktikës**

**Aktivitete dhe veprimtari të tjera zbavitëse**

**Aktivitete sportive**

**Temat e kopshtit**

Për reklamimin e produkteve dhe shërbimeve tuaja në buletin tonë, kontaktoni nëpërmjet postës elektronike.



## "Drejt Evropës"

Libri më i ri i botuar nga shkolla jonë, me punimet e përzgjedhura të nxënësve.

"Drejt Evropës" është titulli i projektit, i cili u finalizua me 9 Maj, data që përkon me Ditën e Evropës.

Botimi i këtij libri, i cili reflekton jo vetëm kreativitetin, por edhe dëshirën e nxënësve tanë, sikundër dëshirën e gjithë shqiptarëve për ta parë Shqipërinë si gjithë Evropa, vjen si një urim për këtë ditë.

Ky libër është pasqyrim i ideve të nxënësve përmes talentit në krijime e vizatime, në lidhje me atë çka ata presin nga ne të rriturit, si edhe një mënyrë për të shprehur ëndrrat e tyre për një Shqipëri më të mirë, më të zhvilluar e më të bukur, që shkon drejt Evropës.





*Shoqëria "Turgut Özal Education" sh.a. nënshkruan marrëveshje me Kolegjet CATS, pjesë e Cambridge Education Group Limited "CEG"*

Nxënësit e shkollave jopublike "Turgut Özal" dhe "Memorial International School of Tirana", pjesë e shoqërisë "Turgut Özal Education" sh.a., do të kenë tashmë mundësinë për të studiuar në Kolegjet CATS në Angli, Evropë dhe SHBA, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe që u nënshkrua midis "Turgut Özal Education" sh.a. dhe Cambridge Education Group Limited "CEG".

Kjo marrëveshje do të mundësojë aksesin ekskluziv të nxënësve të shkollave jopublike "Turgut Özal" dhe "Memorial International School of Tirana", për të fituar të drejtën e studimit me tarifa speciale në çdo kolegji CATS në Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA. Nxënësit që përfundojnë klasën e 9-të ose të 10-të në shkollat "Turgut Özal" dhe "Memorial International School of Tirana" do të kenë mundësinë të përfundojnë studimet parauniversitare në kolegjet CATS, me bursa të bazuara në merita. Kjo do ta bëjë shumë më të lehtë aksesimin në universitetet e Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA-së.

"Mundësitë për të studiuar jashtë vendit për studentët shqiptarë në ditët e sotme janë shumë më të mëdha. Duke u bërë pjesë e kësaj marrëveshjeje, nxënësve tanë u jepet mundësia të njihen me kultura të ndryshme dhe të përfitojnë një edukim ndërkombëtar cilësor, i cili është i nevojshëm në lidhje me ekonominë e sotme globale," u shpreh Z. Mustafa Ustuner, Administrator i Përgjithshëm i "Turgut Özal Education" sh.a. Ai shtoi se bashkëpunimi me institucione prestigjioze në tregjet botërore të arsimit, hap mundësi të reja për studentët shqiptarë për të studiuar në shkolla të njohura në të gjithë botën.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, planifikohet që pranimi i nxënësve në kolegjet CATS të fillojë në shtator 2019.

## Vizita në Institucione

### *Klasa e 3F viziton Ambasadën e Shteteve të Bashkuara*

Një aktivitet shumë i veçantë për nxënësit e klasës së 3F ishte vizita në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, nëpërmjet programit “Njihu me Amerikën”. Ata u takuan me Zv. Shefen e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, Lucija Straley, dhe Rreshterin e Marinsave, Omar Morales, për të mësuar më shumë mbi Shtetet e Bashkuara.

Nxënësit, të cilët sapo kishin mbyllur një javë mësimore mbi Shtetet e Bashkuara, prezantuan disa të dhëna historike dhe interesante që ata kishin mësuar për Amerikën.

Nxënësit u mikpritën nga përfaqësuesit e ambasadës, të cilët në fillim i njohën mbi punën e tyre në ambasadë, dhe më pas u shoqëruan në ambiente të ndryshme të ambasadës. Momenti më i bukur dhe më emocionues i kësaj vizite, ishte kur nxënësit kënduan këngën “Earth song”, e cila u prit me shumë duartrokitje.



### *Vizita e klasave të gjashtave në Këshillin Bashkiak*

Klasa e 6D dhe e 6C vizituan institucionin e Këshillit Bashkiak. Nxënësit u takuan me Kryetarin e Këshillit Bashkiak, Z. Aldrin Dalipi, i cili pasi i mirëpriti në ambientet e këshillit, u dha fëmijëve një informacion të përgjithshëm për mënyrën se si funksionon bashkia dhe se si merren vendimet zyrtare.

Nxënësve iu dha dhe mundësia për të bërë rolin e këshilltarëve, ku arritën të jepnin propozime se si mund ta bënin qytetin tonë, Tiranën, një vend më të mirë. Falë kësaj eksperience, fëmijët arritën të mësonin shumë gjëra të reja dhe gjithashtu të ndanin opinionet e tyre me Z.Dalipi dhe me njëritjetrin.





### ***Klasa e 8B në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural***



Në kuadrin e aktiviteteve për njohjen e institucioneve dhe funksioneve të tyre, nxënësit e klasës së 8B zhvilluan një vizitë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Aty u pritën nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë, Z. Enea Hoti, nën shoqërimin e të cilit nxënësit panë nga afër ambientet e brendshme të ministrisë dhe mësuat historikun e tyre. Ata diskutuan rreth funksionit që Ministria e Bujqësisë kryen në Shqipëri, rolit të saj dhe mbështetjen që ky institucion iu ofron fermerëve dhe investitorëve të ndryshëm. Gjatë vizitës së tyre, nxënësit mësuat gjithashtu më shumë rreth zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë në vendin tonë.



### ***Në Muzeun e Gjergj Kastriotit, Krujë, me klasën e 4A***

Klasa e 4A zhvilloi një vizitë në qytetin e Krujës, në vazhdim të nismës "Edukimi përmes kulturës", duke qenë se kalaja e Krujës strehon një nga muzetë më të rëndësishëm të historisë së Shqipërisë. Nxënësit si fillim bënë një ecje në Pazarin karakteristik të Krujës, ku sende artizanale shqiptare nga më të ndryshmet shiteshin deri pranë dyerve të kalasë. Kur hynë brenda në muze, ata u pritën nga një ciceron, i cili u foli hollësisht për historinë e lashtë të vendit tonë. Nëpërmjet dokumenteve, fotografive dhe objekteve historike të paraqitura në stendat e muzeut, nxënësit u njohën me luftërat e lavdishme të arbërve nën udhëheqjen e Skënderbeut.

## Aktivitetet e Klubit Shpresa



### ***Klubi Shpresa në Shoqatën Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara***

Anëtarët e klasave të 7-ta të Klubit Shpresa, organizuan një aktivitet bamirësie në Shoqatën Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, gjatë të cilit u shpërndanë 50 pako me ushqime për familjet në nevojë. Falenderojmë nxënësit tanë dhe prindërit e tyre për mbështetjen, bujarinë dhe humanitetin që tregojnë gjithmonë!

### ***Klubi Shpresa ndihmë në Shoqatën Kombëtare të Jetimëve***

Anëtarët e klasave të 4-ta të Klubit Shpresa, organizuan një aktivitet bamirësie me ndihma ushqimore për 60 familje të Shoqatës Kombëtare të Jetimëve, dega Tiranë.



### ***Mjete shkollore dhe lodra në shkollën "16 Shtatori", Pezë e Madhe***

Nxënësit e klasës së parë dhe anëtarë të Klubit Shpresa njëkohësisht, iu dhuruan ndihma në mjete mësimore për kopshtin dhe libra jashtëshkollore për bibliotekën e shkollës, moshatarëve të tyre në kopshtin e shkollës "16 Shtatori" në Pezë të Madhe. Vogëlushët u miqësuan shpejt me 'të zotët e shtëpisë' dhe shpalosën talentin e tyre në një minikoncert të përbashkët me këngë e recitime.



### ***Klubi Shpresa dhuron ndihma për 13 familje të Fshatit SOS***

Anëtarët e Klubit Shpresa të klasave të 6-ta, dhuruan ndihma në paketa ushqimore për një periudhë njëmuajore për 65 fëmijë të Fshatit SOS në Tiranë, të cilët jetojnë në 13 familje dhe përfshihen në Programin me Bazë Familjen, një nga programet me të cilat funksionon ky fshat.

Nxënësit panë nga afër ambientet e këtij fshati dhe kuptuan se si zhvillohet jeta aty. Nxënësit jo vetëm ndihmuan me dashuri dhe bamirësi, por duke vizituar Fshatin SOS përjetuan emocione të veçanta dhe mësuam edhe më shumë për kujdesin dhe mbështetjen e familjes, si nevojë primare në rritjen dhe edukimin e një fëmije.



### ***Mjete shkollore dhe lodra në shkollën “Haxhi Korra”***

Nxënësit e klasave të dyta, anëtarë të Klubit Shpresa, u dhuruan ndihma në mjete mësimore për kopshtet dhe libra jashtëshkollore për bibliotekën e shkollës, bashkëmoshatarëve të tyre në shkollën “Haxhi Korra”. Për 55 fëmijët e kopshtit që ndodhej në godinën e shkollës dhe një kopshti vartës, ishin përgatitur pako me mjete më të nevojshme mësimore. Gjithashtu u dhuruan dhe mjete të përgjithshme dhe lodra për të dy kopshtet. Mes kënaqësisë, fotove dhe buzëqeshjeve, vogëlushët shijuan vërtet momente të paharrueshme, që i fal vetëm mirësia dhe humanizmi.

## Konkurse dhe olimpiada



### Përgatitjet për ASEF 2019

Përgatitjet për Olimpiadën e Projekteve ASEF 2019 filluan me regjistrimet dhe gjatë kësaj periudhe u pa entuziazmi i nxënësve teksa regjistronin projektet, me të cilat do të përfaqësoheshin dhe do të krijonin grupet e punës. Së bashku me mësuesit mentorë, u përgatitën për një paraqitje sa më dinjitoze, në këtë konkurs të njohur tashmë brenda e jashtë vendit.

### Asef 2019

Konkursi Shkencor ASEF (Albanian Science and Engineering Fair), solli sërish një larmishmëri prezantimesh, të realizuara me profesionalizëm dhe kreativitet të lartë.

Ky konkurs, në të cilin kishte pjesëmarrës nxënës nga shkollat "Turgut Özal" Tiranë, MIST, "Turgut Özal" Durrës dhe "Hasan Riza Pasha" Shkodër solli një numër të madh projektesh, në kategori të tilla, si: Mathematics, Linguistics, Biological Sciences, Web Design, Programming, Robotics, Physical Science, Installation Art, Short Movie, Industrial Design, Poster Design dhe Other Social Sciences.

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Turgut Özal" u vlerësuan me 90 Medalje bronzi, 62 Medalje argjendi dhe 29 Medalje ari.





## Olimpiada Cogito

Olimpiada Shkencore Cogito u zhvillua në datën 11 maj 2019, në ambientet e kompleksit “Turgut Ozal”.

Shkolla jonë u përfaqësua nga 75 nxënës, të cilët u paraqitën shumë mirë, duke fituar këto çmime:

Në Matematikë 3 medalje ari, 5 argjendi dhe 6 bronzi, në Fizikë 4 medalje ari, 10 argjendi dhe 5 bronzi, në Kimi 2 medalje ari, 4 argjendi dhe 4 bronzi, në Biologji 6 medalje ari, 8 argjendi dhe 3 bronzi, në Kompjuter 1 medalje ari dhe 2 bronzi, në Anglisht 1 medalje ari, 1 argjendi dhe 1 bronzi.

Gjithsej nxënësit e shkollës sonë fituan:

17 Medalje ari

28 Medalje argjendi

21 Medalje bronzi



## “Word Skills Competition” në klasat e 6-ta

Një aktivitet shumë i pëlqyer nga nxënësit e klasave të 6-ta për Javën e Anglishtes është “Word Skills Competition”. Fituese doli klasa e 6E. Gjithashtu, paraleli i klasave të 6-ta, për Javën e Anglishtes, zgjodhi të punonte me shtetin e Britanisë së Madhe. Secili nxënës zgjodhi një aspekt të ndryshëm, si: historia, gjeografia, dialektet gjuhësore, pallati mbretëror, arti, muzika etj., dhe punoi një projekt. Një nga stendat kryesore ishte dhe minibiblioteka e krijuar nga nxënësit, me të gjithë librat që ata kishin në gjuhën angleze.

### **Konkursi i këngës në Javën e Anglishtes**

Me ardhjen e Javës së Anglishtes erdhi edhe një aktivitet tjetër i parapëlqyer shumë si nga nxënësit, po ashtu edhe nga mësuesit: Konkursi i Këngës.

Konkursi i Këngës për klasat e shkollës fillore u zhvillua gjatë dy ditëve në Sallën e Koncerteve. Nxënësit, të emocionuar dhe me ndjenjën e konkurrencës, ngjiteshin në skenë dhe performonin, duke dhënë maksimumin e tyre.



### **Konkursi i këngës “Zëri më i bukur”**

Një aktivitet i organizuar për të apasionuarit e këngës ishte edhe Konkursi “Zëri më i bukur”, i zhvilluar në gjuhën shqipe dhe atë turke. Ky konkurs u zhvillua me pjesëmarrjen e nxënësve nga të gjitha kolegjet. Juria përbëhej nga emra të njohur të muzikës shqiptare. Konkurrentët u vlerësuan në bazë të disa karakteristikave: zërit, performancës dhe të folurit e të shqiptuarit të gjuhës turke. Fituesit e tri vendeve të para përfaqësuan vendin tonë në Festivalin Internacional të Gjuhës dhe Kulturës.







## **Klea Kaloshi në Festivalin “Colours of the World” në New York**

Klea Kaloshi përfaqësoi denjësisht jo vetëm shkollën, por edhe vendin tonë në festivalin “Colours of the World” në New York. Ky festival ka si qëllim njohjen e kulturave dhe gjuhëve të vendeve të ndryshme dhe u prezantuan rreth 2000 performues nga 160 shtete.


Gjithashtu, në datat 4-23 qershor, nxënësja Emi Baloshi do të përfaqësojë shkollën në një tjetër aktivitet të ngjashëm, i cili do të zhvillohet në Gjermani dhe Belgjikë.

## **Zhvillohet faza e dytë e Konkursit Owlypia**

U zhvillua në ambientet e kolegjit “Turgut Özal” faza e dytë e konkursit Owlypia, e quajtur “Owlypia Locals”. Konkursi mbledhi nxënës jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga Kosova e Bosnje-Hercegovina. Ai përfshinte disa faza konkurrimi dhe u zhvillua përgjatë dy ditëve. Pasi përfunduan të gjitha fazat e konkursit, të cilat jo vetëm përçuan dije, por edhe emocione, erdhi momenti i ndarjes së çmimeve, ku u shkrepën qindra foto. Salla kumbonte prej brohoritjeve dhe duartrokitjeve përgëzuese. Ankthi i ëmbël ishte zëvendësuar prej kujtimeve të ngrohta të asaj fundjave të ethshme, plot emocione, dije dhe medalje fitoreje.

Gjithashtu, në vazhden e konkursit Owlypia, 11 nxënës të shkollës sonë do të marrin pjesë në garën ndërkombëtare “The Intellectual’s Challenge”, në datat 16-23 qershor në Angli.





### ***IQ Test***

Java e Matematikës solli konkurse e veprimtari të shumta zbavitëse e logjike, ndër të cilat u organizua dhe IQ test (Testi i Inteligjencës), ku morën pjesë nxënës nga klasat e 6-ta deri te klasat e 9-ta dhe patën mundësinë të testojnë inteligjencën e tyre. Testi kishte pyetje të ndryshme, që përfshinin pyetje IQ ose pyetje për punimin e objekteve të ndryshme. Tri vendet e para u vlerësuan me certifikatë.

### ***Konkursi i Mangalas***

Konkursi i Mangalas u zhvillua gjatë Javës së Matematikës dhe u pëlqye shumë nga nxënësit. Gjatë konkursit mund të dalloje entuziazmin e nxënësve për të mësuar më shumë për këtë lojë dhe gjithashtu vëreje mirëkuptimin dhe bashkëpunimin me njëri-tjetrin. Në fund të konkursit u shpallën 3 fituesit, të cilët u vlerësuan dhe me certifikatë.







### **Provimi i matematikës Kangaroo në shkollën “Turgut Özal”**

Një nga aktivitetet e organizuara kohët e fundit dhe që i testoi nxënësit në lëndën e matematikës ishte provimi Kangaroo. Rreth 450 nxënës të shkollës sonë konkurruan dhe dhanë më të mirën e tyre.

Kangaroo është një konkurs që ka për qëllim të njohë nxënësit dhe mësuesit me problemat dhe ushtrimet matematikore të programit shkollor në një mënyrë të këndshme, tërheqëse dhe pa ankthin e domosdoshëm të konkurrimit.

### **Oxford Placement Test**

U zhvillua faza e dytë e provimit të Oxford Placement Test ose ndryshe OPT, një test i mundësuar nga shkolla jonë, i cili teston njohuritë e nxënësve në gjuhën angleze. Ky testim zhvillohet për nxënësit nga klasat e 3-ta deri në klasat e 9-ta, në fillim dhe në fund të vitit shkollor, pra dy herë në vit. Provimi bëhet në kompjuter dhe ndahet në tre pjesë kryesore: Përdorimi i gjuhës, Leximi dhe kuptimi i gjuhës, si dhe Dëgjimi.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e tyre në dëgjim e në përdorimin e drejtë të gjuhës dhe në fund marrin një certifikatë, e cila pasqyron nivelin e tyre të anglishtes.

### **Provimet e anglishtes KET dhe PET**

Për të certifikuar nivelin e tyre të anglishtes, nxënësit e klasave të 6-ta dhe të 8-ta morën pjesë përkatësisht në provimet KET dhe PET, provime të standardizuara online të Cambridge University. Provimet u organizuan në tri ditë të ndryshme, sipas kategorive Reading, Writing dhe Listening. Këto janë provime që prej vitesh tashmë zhvillohen në shkollën tonë dhe si çdo vit, disa javë pas provimit nxënësit pajisen me certifikata, ku tregohen aftësitë e tyre në të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit e gjuhës angleze.





### **Kampionati i Shahut**

Kampionati i Shahut është nga aktivitetet më të dashura të Javës së Matematikës dhe u zhvillua me nxënësit e klasave të teta dhe të nënta. E njohur si loja e njerëzve me dhunti intelektuale, është më shumë si një lloj sporti i krijuar nga mendja. Gjatë lojës së shahut duhet jo vetëm inteligjencë, por dhe një formulim i mirë strategjish, dhe kjo nxënësve tanë nuk u mungon. Njohja e nxënësve me shahun, jo vetëm i ndihmon të nxitin koeficientin e inteligjencës, por i bën dhe më kreativë.

### **“Kreativiteti përtej kufijve”**

Në bashkëpunim me Intellectuals Challenge, shkolla “Turgut Özal” organizoi në ambientet e saj, në datat 9-10 Mars, konkursin “Owlypia”. Pas pjesëmarrjes së suksesshme të nxënësve në Owlypia Online, erdhi radha e Owlypia Local, sfidës së re për intelektualët e vegjël. Konkursi i këtij viti kishte temë qendrore “Kreativitetin përtej kufijve”. Tema kryesore u shtjellua në disa kategori, si: Art dhe dizajn, Shkencë dhe ekonomi, Letërsi dhe kulturë, Shkencë dhe teknologji.





### ***Nxënësit e kolegjit "Turgut Özal" konkurrojnë në Infomatrix, Rumani***

Nxënësit finalistë të shkollës sonë morën pjesë në Olimpiadën Infomatrix, të organizuar në Bukuresht të Rumanisë në datat 20-23 prill.

Në këtë olimpiadë nxënësit tanë u përfaqësuan me 2 projekte.

Projekti i parë ishte në kategorinë Robotics Lego Line Follower, ku konkurruan nxënësit e klasës së gjashtë Joel Shehu dhe Noel Osmaj, të cilët u vlerësuan me Certifikatë pjesëmarrjeje.

Projekti i dytë ishte në kategorinë Robotics Lego Sumo, ku konkurruan nxënësit Drini Dulaj, klasa e gjashtë dhe Henri Llanaj, klasa e pestë, të cilët u vlerësuan me Medalje bronzi.



### ***Nxënësit e kolegjit "Turgut Özal" në GENIUS Olympiad 2019***

Klubi i Robotikës është një klub që ndihmon nxënësit të mësojnë më shumë për inxhinierinë, duke e vënë në praktikë atë. Këtë vit skuadra jonë krijoi një robot në formë krah, të ndërtuar duke përdorur Lego. Me këtë krijim ky grup do të marrë pjesë në një olimpiadë shumë të veçantë: Genius Olympiad. Pjesëmarrës të këtij viti janë nxënësit Brendon Janku, Martin Lipe dhe Aurel Domi.

Ndërsa në kategorinë muzikë do të konkurrojnë nxënëset Adea Rreshka dhe Dea Merkaj. Me këngën "Scars to your beautiful", të përzgjedhur nga Adea Rreshka, ne duam të përcjellim rëndësinë e bukurisë shpirtërore, ndërsa me këngën "Read all about it", e kënduar nga Dea Merkaj, mesazhin e lirisë së fjalës dhe mendimit. Olimpiada GENIUS do të zhvillohet në datat 17- 22 qershor në Oswego, SHBA.



## Takime dhe biseda

### **Bashkëbisedim me pedagogen e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, Znj. Majlinda Keta**

Një bashkëbisedim për librin, ëndrrat dhe arsimin u zhvillua mes nxënësve të Klubit të Medias, të Klubit “Awareness”, lexuesve të apasionuar nga klasat e 8-ta e të 9-ta dhe Znj. Majlinda Keta, pedagoge e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës. Ky takim u organizua në ambientet e bibliotekës, mes një bisede të ngrohtë, për të informuar, ndërgjegjësuar dhe duke iu përgjigjur nxënësve rreth pyetjeve të ndryshme që ata kishin, jo vetëm ndaj arsim-it, por edhe filozofisë, rolit të gruas në shoqëri dhe suksesit në karrierë.

Atmosfera e këndshme, e cila erdhi nga natyra përparimtare dhe interaktive e bisedës, mbushi të gjithë sallën. Secili nga nxënësit u motivua nga ky takim kaq frymëzues dhe plot vlera.



### **Klasa e 4B orë e hapur në lëndën e historisë me Prof. Asoc. Dr. Belina Budini**



Bashkimi Evropian është destinacioni ku Shqipëria e sheh veten në të ardhmen. Ky Union ka shumë benefite, të cilat do ta ndihmojnë Shqipërinë të ecë më shpejt drejt zhvillimit dhe një jetese më të mirë. Për këtë temë kaq të rëndësishme diskutuan dhe nxënësit e klasës së 4B bashkë me Prof. Asoc. Dr. Belina Budini, Drejtuese e Departamentit të Komunikimit në Universitetin Evropian të Tiranës. Në një atmosferë shumë aktive dhe pjesëmarrëse, nxënësit mësuan rreth përkatësisë evropiane të Shqipërisë, duke paraqitur idetë dhe mendimet e tyre edhe për projektin “Drejt Evropës”.



### ***Përfaqësues të Institutit Konfuci në klasën e 4E***



Klasa e 4E paraqiti veçantitë dhe bukuritë e Kinës, si zgjedhje për konkursin “Culture Corner”, duke pasur kështu mundësinë për një vizitë të disa përfaqësuesve nga Instituti Konfuci. Nxënësit e pritën shumë të lumtur këtë vizitë. Gjatë bashkëbisedimit të përzemërt që u zhvillua midis nxënësve dhe miqve, nxënësit u folën nga pak në gjuhën kineze. Përfaqësuesit e këtij institucioni u kënaqën shumë nga përpjekjet e mëdha që kishin bërë nxënësit.

### ***Përfaqësues të Ambasadës Holandeze në klasën e 2B***

“Këta nxënës të vegjël bënë prezantime për Holandën, traditat, natyrën, historinë dhe zakonet tona. Ne mbetëm shumë të impresionuar nga njohuritë dhe përpjekjet e tyre, veshjet e tyre holandeze dhe veçanërisht nga prezantimi që bënë në gjuhën tonë. Ishte kënaqësi që për disa orë ishim pjesë e kësaj ‘Holande të vogël’!”, kështu u shprehën përfaqësuesit e Ambasadës Holandeze në vizitën e bërë në kolegjin “Turgut Özal”.

Ishin nxënësit e klasës së 2B, të cilët kishin zgjedhur Holandën për Javën e Anglishtes, që shpalosën talentin e tyre në një prezantim të mrekullueshëm, në të cilin morën pjesë dhe dy përfaqësues të Ambasadës Holandeze në Shqipëri. Kreativiteti i tyre shkëlqeu përmes projekteve, të cilat kishin mbuluar muret e klasës dhe me duart e vogla punëtore kishin krijuar një “Holandë të vogël”.





***Bisedë me profesorin, gazetarin dhe përfaqësuesin e shoqërisë civile, Z. Erion Kristo.***

Profesori dhe gazetari i mirënjohur, Z. Erion Kristo, zhvilloi me nxënës të ciklit 9-vjeçar një bashkëbisedim të këndshëm, të çiltër dhe me shumë vlera. Ky panel diskutimi u organizua nga Klubi “Awareness” dhe me disa përfaqësues nga Klubi i Medias i shkollës sonë. Nxënësit pjesëmarrës fillimisht u prezantuan, duke u ndalur te preferencat e tyre, ambiciet e së ardhmes etj. Gjatë bisedës u shkëmbyen edhe batuta, të cilat i dhanë asaj një trajtë të këndshme dhe shumë miqësore. U trajtuan mjaft tema interesante të fushave të ndryshme si: komunikimi, leximi i librave, interesat dhe aspiratat e nxënësve. Faleminderit profesor për bisedën aq të bukur e plot vlera!



### ***Bashkëbisedim me Znj. Blerina Ago, këshilltare në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit***

Një bashkëbisedim i singertë e frymëzues, ishte takimi i nxënësve të ciklit 9-vjeçar me Znj. Blerina Ago, këshilltare në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Paneli i diskutimit u organizua nga Klubi “Awareness” i shkollës sonë. Bashkëbisedimi u fokusua në zhvillimet e turizmit të aventurës, si dhe në mjaft eksperiencë të këndshme, të cilat Znj. Blerina, si një ndjekëse e apasionuar e sportit rafting, që po bëhet një trend kohët e fundit, i ndau me nxënësit pjesëmarrës. Bashkëbisedimi u fokusua edhe tek fakti se ata vetë mund të ndihmonin në zhvillimin e turizmit, duke shpërndarë nëpër rrjetet sociale foto dhe video të Shqipërisë, apo sajë vullnetarizmit.



## Mësojmë përmes praktikës



### *Java e Matematikës*



Java e Matematikës u zhvillua edhe këtë vit me veçantitë e saj, si në shkollën fillore, ashtu dhe në shkollën 9-vjeçare, përmes një sërë aktivitesh dhe lojërash matematikore dhe logjike. Njohuritë dhe kuriozitetet e ndryshme në lëndën e matematikës, nxënësit i paraqitën edhe nëpërmjet posterave, trupave gjeometrikë, miniaturave të ndërtesave të njohura të bëra prej tyre, projekteve 3D, si dhe bluzave me thënie të ndryshme për lëndën e matematikës. Gjatë kësaj jave spikatën edhe lojërat e shpejtësisë me shumëzime e pjesëtime. Një nga konkurset që mori vëmendjen e të gjithëve ishte Sudoku.

Nxënësit e morën shumë seriozisht këtë garë dhe punuan fort për të fituar.





### ***Java e Anglishtes***

Aktiviteti që kulmoi Javën e Anglishtes së këtij viti shkollor ishte “Këndi i Kulturës”. I organizuar nga nxënësit e shkollës fillore, ky ishte një aktivitet që mori vëmendjen e të gjithëve. Çdo klasë zgjodhi një shtet dhe më pas i gjithë dekorimi i klasës u bë në bazë të vendit të zgjedhur. Secili nxënës solli një projekt, ku shtjelloi një temë të veçantë brenda shtetit, si: kultura, gjuha, veshjet, festat etj. Spikati veçanërisht prezantimi i revistave tek klasat e 6-ta. Të gjitha klasat arritën të botojnë revista interesante dhe të ndryshme nga njëra-tjetra.



Shkolla është një institucion arsimor-edukativ që të përgatit për jetën, dhe si e tillë, ajo është në sfidë të vazhdueshme për t'iu përshtatur të rejave më të fundit të kohës.


Për këtë arsye, këtë vit zgjodhëm të pilotojmë platformën IXL, e cila përdoret nga mbi 7 milionë nxënës në më shumë se 191 vende dhe ka fituar një sërë çmimesh nga më të njohurat në botë në fushën e edukimit.

IXL- jo vetëm që ofron një gamë mjaft të gjerë ushtrimesh dhe pyetjesh online, por e veçanta e kësaj platforme është se i siguron mësuesit të klasës një statistikë të detajuar, duke ndjekur ecurinë e grupit në tërësi dhe performancën e secilit nxënës në veçanti.

Pilotimi i kësaj platforme në lëndën e matematikës, me nxënësit e klasës së 4A, pati rezultate më të larta sesa i kishim parashikuar. Vetëm brenda një muaji, nxënësit iu përgjigjën më shumë se 50 mijë pyetjeve dhe një pjesë e madhe e tyre e konsideruan detyrën e shtëpisë në IXL si “mjaft interesante dhe argëtuese”.

Pas pilotimit të suksesshëm të IXL, kemi hedhur një hap të sigurt për ta përdorur atë gjatë vitit të ardhshëm shkollor në lëndën e matematikës në të gjitha klasat e treta, të katërta dhe të pesta të ciklit fillor.

## ***Platforma IXL vjen për herë të parë në shkollën tonë***



## ***Mësojmë përmes praktikës në laboratorin e biologjisë***

Nxënësit e klasave të 9-ta, morën pjesë në një eksperiment shumë interesant. Nën mbikqyrjen e mësuesit të biologjisë, nxënësit mësuan si të ekstrahonin ADN-në e një fruti. Duke përdorur përbërës të thjeshtë, të cilët gjenden dhe në shtëpi, si ujë, detergjent enësh dhe alkool, ia dolën të arrijnë rezultatin e duhur. Kjo ishte një eksperiencë shumë e bukur për nxënësit, të cilët u argëtuan duke mësuar.





## ***Në laboratorin e fizikës me klasën e 8B***

Klasa e 8B zhvilloi një orë mësimi ndryshe në lëndën e fizikës, ku u zhvilluan disa eksperimente të ndryshme rreth temës së mësimi “Refraction of Light”. Eksperimentet e ndryshme u mundësuan nxënësve të mësonin gjëra të reja rreth fizikës, duke u argëtuar në të njëjtën kohë. Eksperimentet u kryen me anë të lazerave të ndryshme që ndodhen në laboratorin e fizikës.



## ***Mësojmë më shpejt në sajë të eksperimenteve***

Të mësuarit përmes praktikës, është gjithmonë efektiv dhe shumë i pëlqyeshëm nga nxënësit, sepse e bën orën e mësimi zbavitëse dhe dijet përvetësohen më thjesht. Në këtë mënyrë, nxënësit e klasës së 8D kanë zhvilluar përmes eksperimenteve tema të tilla si: fusha magnetike e magnetit, forca tërheqëse e tij, elektromagnetit etj.



## ***Aplikojmë njohuritë në fizikën me zgjedhje me klasën e 7E***

Mësimi i fizikës duhet të ndërtohet duke respektuar proceset e njohjes brenda mendjes njerëzore. Këto procese zhvillojnë zakone të dëshirueshme të mendjes, ndërtojnë njohuri/dije të strukturuar dhe udhëheqin mendimin. Për këtë arsye fizika me zgjedhje për klasat e 7-ta zhillohet me demonstrim, ku çdo njohuri e fituar teorikisht vendoset në zbatim. Nxënësit ndjekin parimin “të mësosh duke vepruar” dhe kjo bën që përfitimet nga fizika të përfshijnë qasje praktike për zgjidhje problemesh, aftësi për arsyetim të qartë dhe komunikim idesh komplekse.



## ***Klasa e 1E në orën e edukatës shoqërore***

Nxënësit e klasës së 1E zhvilluan një orë mësimore të veçantë, sipas temës “Shoku dhe shoqja juaj”, në lëndën e edukatës shoqërore. Me ndihmën e mësueses fëmijët përgatitën dhe ngjitën në murin e klasës “Pemën e miqësisë” dhe pasi prenë kartona me madhësinë e dorës e që përsipër mbanin emrat e tyre, i vendosën rreth e rrotull saj në formën e degëve. Më pas u ndanë në grupe dhe duke shkëmbyer pyetje-përgjigje mes tyre, me fjalë të thjeshta ata folën rreth vlerave më të rëndësishme të saj, si sinqeriteti, ndihma, besnikëria, toleranca, vlerësimi e respekti.





## ***Klasa e 1G mëson rregullat e sjelljes me një të panjohur***

Nxënësit e klasës së 1G zhvilluan një orë interesante në lëndën e edukimit për shoqërinë. Tema mësimore “ Unë dhe i panjohuri” solli situata aktrimi, ku mësuesja ishte në rolin e një të panjohuri që u ofronte një çokollatë apo një celular. Reagimi i fëmijëve ishte befasues dhe ai i duhuri, sepse edhe pse të vegjël, ata e dinin mjaft mirë se si duhet vepruar në të tilla raste. Rregullat e arta që rifreskuan dhe mësuan gjatë kësaj ore ishin se nuk duhet të flasin me të panjohurit ose të pranojnë diçka prej tyre, por të bëhen të zgjuar e në raste emergjente të vrapojnë tek prindërit, tek të njohurit apo tek një polic që mund të jetë afër.



## ***Klasat e para në aktrim***

Nuk ka si mesazhi që i transmeton dhe kënaqësia që i jep një fëmije një përrallë e bukur, ndaj nxënësit e klasave të para organizuan me ndihmën e mesueseve, dramatizimin e njërës prej përrallave të tyre më të preferuara: “Kësulëkuqja dhe Ujku”. Për të organizuar rolet më së miri, vogëlushët përdorën edhe kostume të veçanta, që i dhanë një pamje më reale pjesës, duke i bërë ata të besonin se po e jetonin përrallën. Kjo orë mësimore kaq interesante i kënaqi pa masë fëmijët dhe u mësoi që të mos gënjenen nga të panjohurit.



*MINIMAT*





URA 2019





### ***Interpretimi i përrallës “Gjashtë vëllezërit peshkatarë dhe vajza”***

Nxënësit e klasave të dyta performuan në sallën e dramës pjesën teatrale “Gjashtë vëllezërit peshkatarë”. Nxënësit ishin mjaft të angazhuar dhe krijuan me zell të madh skenën e teatrit, si dhe kostumet e bukura që veshën. Përreth kishte një atmosferë shumë të gëzueshme. Spektatorët mezi prisnin të shihnin shokët e tyre të aktronin, e më pas aktorët e vegjël rrëzëllenin nga gëzimi prej duartrokitjeve dhe brohoritjeve të shokëve të entuziazmuar.

### ***Nxënësit e klasave të para mësojnë të mbjellin lule***

Klasat e para kanë zhvilluar një aktivitet që u ka mësuar atyre për rëndësinë e imazhit të gjelbër në mjedisin që i rrethon. Secili nxënës solli një lule të vetën, që e mbolli me ndihmën e mësueses kujdestare, duke krijuar kështu dhe kopshtin e tyre të vogël në oborrin e shkollës. Përmes shpjegimit të mësueses, fëmijët kuptuan jo vetëm rëndësinë e luleve në procesin e frymëmarrjes, por edhe përgjegjësitë që kanë për mbajtjen me rregull të mjedisit që i rrethon.





## ***Nxënësit e klasave të treta zhvillojnë orën mësimore “Mbjellja e bimës”***

Të gjithë nxënësit e klasave të treta u përfshinë në një veprimtari kaq gjallëruese për ta dhe njëkohësisht dobiprurëse për ambientin ku mësojnë, siç është mbjellja e bimëve. Të pajisur me doreza, lopatëza dhe mjete të tjera ndihmëse, fëmijët mbollën bimë të tilla, si: farë sallate, farë fasuleje, karote etj., dhe plot lule me ngjyra nga më të ndryshmet.



## ***Njohim format gjeometrike***

Në orën e matematikës, nxënësit e klasave të para thelluan njohuritë e tyre për format gjeometrike 2D. Pasi u njohën me emërtimet e tyre, mësuam t'i vizatonin dhe i paraqitën para klasës. Në orën në vazhdim, të zellshëm dhe kureshtarë, mësuam për format gjeometrike 3D. Ata ndërtuan lloj-lloj formash të larmishme me duart e tyre, duke i dhënë orës mësimore një frymë argëtimi dhe dëfrimi. Me anë të këtyre formave, duke shaplosur imagjinatën e tyre, ata arritën të ndërtonin shtëpiza prej druri.





### **Projekti “Qyteti im” nga klasa e 3F**

Klasa e 3F ka zhvilluar në lëndën e edukatës shoqërore një projekt me temë: “Qyteti im”. Çdo nxënës ka bërë një projekt 3D të një qyteti model sipas fantazisë së tij. Projektet e krijuara ishin të gjitha të veçanta, kryesisht me shume parqe me gjelbërim dhe me elemente nga imagjinata e fëmijëve, si autobusë të formave e ngjyrave të ndryshme, rrugë të rrethuara me pemë, pallate të pikturuara dhe qendra qyteti të mbushura me lodra e shatërvane.

### **Mësojmë përmes praktikës: Shitblerja dhe përdorimi i monedhave**

Nxënësit e klasave të dyta këtë fund muaji zhvilluan një orë mësimi të veçantë dhe ndryshe nga të tjerat, ku mësuuan nëpërmjet argëtimit. Kjo orë u zhvillua që nxënësit të përvetësonin temën e mësimi në matematikë, atë të shitblerjes dhe njohjes së monedhave. Ata e zhvilluan mësimin jashtë në oborr, ku sollën ushqime dhe lodra të ndryshme, të cilat më pas i shitën me nxënësit e klasave të tjera. Përmes këtij aktiviteti ata jo vetëm mësuuan se si të bëjnë llogari të thjeshta, por edhe se si të negociojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.



### **Nxënësit e klasës së 3F në një aktivitet në Ditën e Tokës**

Data 22 prill, Dita e Tokës, dita kur secili prej nesh ndërgjegjësohet se sa e rëndësishme është që ne të kujdesemi për Të, ta ruajmë e ta mbajmë pastër gjithmonë. Pikërisht në këtë datë, klasa e 3F, pati mundësinë të mernte pjesë në një ekspozitë të organizuar nga Qendra Mjedisore Eden. Në ekspozitë, me punime të nxënësve nga shkolla të ndryshme, u paraqitën mjaft projekte të realizuara nga materiale të riciklueshme, të cilat përçonin mesazhin se ne duhet ta mbrojmë planetin tonë dhe se nuk duhet ta ndotim atë.





## ***Nxënësit e së 4A mes artizaneve krutane***

Me dëshirën për të vlerësuar rëndësinë e punës së dorës dhe mjeshtërinë e grave shqiptare në fushën e zejtarisë, nxënësit e klasës së 4A vizituan ambientet e një ndërmarrjeje artizanati, ku panë nga afër punimet artistike të duarartave krutane. Nxënësit u njohën me mënyrën e realizimit të punimeve me grep dhe punimeve me lëkurë, të qëndisjeve me fije dhe me gurë të çantave, shalleve, sandaleve e aksesoreve të ndryshëm.



## ***Klubi Awariness seminare mbi tematikat e qytetarisë***

Klubi Awareness nisi realizimin e një projekti të ri, i cili ka në fokus organizimin dhe prezantimin e seminareve me tematika të ndryshme të lëndës së qytetarisë. Ky projekt ka qëllim transmetimin e vlerave qytetare nga vetë nxënësit e shkollës sonë, të cilët dinë më së miri se si t'i përcjellin ato tek më të vegjlit e shkollës. Nxënës të ciklit 9-vjeçar përgatitin tema të ndryshme edukative, të cilat ua prezantojnë më pas nxënësve të ciklit fillor.



## ***Sinjalistika rrugore dhe rëndësia e saj***

Një orë praktike për njohjen dhe respektimin e sinjalistikave rrugore dhe rëndësinë e tyre u zhvillua me nxënësit e klasave të treta. U imituan disa situata të përditshme të qarkullimit rrugor, ku fëmijët morën një herë rolin e këmbësorit dhe një herë atë të policit, për të kuptuar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si këmbësorë. Nxënësit bënë gjithashtu një punë të mrekullueshme me projektet e tyre plot fantazi e kreativitet, ku vihej re përkushtimi i tyre maksimal në respektimin dhe zbatimin e sinjalistikës rrugore.



## Aktivitete dhe veprimtari të tjera zbavitëse

### Gëzuar 8 Marsin Nënë!

Festa e 8 Marsit erdhi në kolegjin "Turgut Özal" përmes koncerteve festive të organizuara për këtë ditë të veçantë. Koncertet filluan nga grupet e parashkollorit dhe vijuan te nxënësit e klasave më të larta. Mes rrezeve të diellit, luleve dhe atmosferës së gëzueshme të këngëve, recitimeve, kërcimeve dhe performimeve të tjera, këta nxënës përcollën aq bukur e me ngjyrat e jetës mesazhin universal që kjo festë përçon: "Dashurinë e pafund për Nënën, që na rritin me dije, me dashuri e jetë!"



### Mes emocioneve të shfaqjes muzikore "Shitësja e vogël e shkrepseve"

Muaji Mars nisi me performancën e mrekullueshme të nxënësve të klasave fillore, të shfaqjes "Shitësja e vogël e shkrepseve". Kjo shfaqje, e përshtatur nga përralla e njohur me të njëjtin titull e H. K. Andersen, ndërthurur me personazhet e preferuara të përrallave dhe filmave për fëmijë, si: Borëbardha, Hirushja, Arieli, Pipi Çorapegjata etj., solli emocione te çdo spektator. Interpretimi i artistëve të vegjël, së bashku me muzikën, vallëzimin, dritat dhe efektet mbresëlënëse skenike i dhanë shumë jetë dhe gjallëri shfaqjes.







### ***“Qyteti i fëmijëve”, një qytet i plotësisht të ëndrrave***

“Qyteti i fëmijëve”, një shfaqje muzikore bazuar në variantin e operetës “Të ndërtojmë një qytet”, e vitit 1930 nga P.Hindemith, erdhi në shkollën tonë e interpretuar nga nxënësit e klasave të katërta, të pesta e të gjashta. Ideja e shfaqjes muzikore ishte ndërtimi i një qyteti të veçantë, një qytet vetëm me fëmijë, për t’u treguar nënave që fëmijët e tyre mund t’ia dalin edhe vetë. Mesazhi se dhurata më e bukur që mund t’u bëhet nënave e mësuesve janë vetë fëmijët, u përçua mjaft bukur përmes interpretimeve të arrira të këtyre nxënësve të talentuar.

### ***Nxënësit tanë marrin pjesë në ekspozitën “Një zë kundër bullizmit”***

Nxënësit tanë morën pjesë në ekspozitën “Një zë kundër bullizmit”, ku janë bërë së bashku nxënës nga 21 shkolla të Shqipërisë. Kjo ekspozitë u realizua nga COD (Qendra për Hapje dhe Dialog), në bashkëpunim me Këshillin e Evropës në Tiranë, në kuadër të programit “Kundër Bullizmit dhe Ekstremizmit në sistemin arsimor”. Nxënësit pjesëmarrës në ekspozitë, përmes ngjyrave dhe ideve, sollën mesazhe për paqe, tolerancë, unitet dhe respekt për diversitetin, si mënyra për të parandaluar dhe reduktuar fenomenin e bullizmit në shkolla.



### ***Shëtitja e klasave të 6-ta në Mavrovë***

Një fundjavë e rrethuar nga bardhësia e dëborës, pamje magjepsëse dhe shoqëri e mirë. Ishin nxënësit e klasave të gjashta, që vendosën të mblidheshin bashkë e të kalonin një fundjavë ndryshe. Mavrova ishte destinacioni kryesor. Gjatë ditës së parë nxënësit luajtën lojëra me borë dhe provuan kënaqësinë e të rrëshqiturit në grup me slita, si dhe notuan në pishina, kur jashtë temperaturat ishin të ulëta dhe bora kishte zbardhur çdo gjë. Ndërsa në Ohër, nxënësit do të shijonin edhe pamjet e mrekullueshme dimërore të liqenit të Ohrit.



### ***Klasat e 3-ta shëtitje në Maqedoni e Kosovë***

Nxënësit e klasave të treta ishin pjesë e një udhëtimi treditor në Maqedoni e Kosovë. Udhëtimi nisi me rrugëtimin drejt qendrës turistike "Kodra e Diellit". Çdo gjë ishte e veçantë, ngjitja në malin më të lartë të Maqedonisë, akomodimi në hotel "Scardus", pastaj lojërat me slita e me topa bore, pishinat dhe ushqimet e shijshme. Shëtitja vazhdoi vrullshëm e me entuziazëm drejt Shkupit legjendar, me ndërtesat e vjetra dhe monumentet historike, me vizitën në një qendër tregtare dhe shumë aktivitete të tjera. Qyteti i tretë që mirëpriti fëmijët ishte Prizreni. Fillimisht vizituan shtëpinë ku u mbajt Lidhja e Prizrenit dhe më pas shëtitën nëpër qytet, për të shijuar gjithë trashëgiminë kulturore dhe shtëpitë ende me stilin e dikurshëm e karakteristik të ndërtimit. Pasi shijuan të gjitha bukuritë dhe ndjesitë që ky udhëtim u dhuroi, u kthyen në qytetin e tyre, të pasuruar me dije dhe emocione të reja.







### ***Në Mal të Zi me klasat e 4-ta e të 5-ta***

Klasat e katërta e të pestave zhvilluan një ekskursion disaditor në vendet e mrekullueshme turistike të Malit të Zi. Ndalesa e parë u bë në qytetin mikpritës të Shkodrës, pikërisht buzë lumit Buna, ku edhe drekuan e bënë fotografi të shumta. Me kalimin e vijës kufitare destinacioni i parë ishte ujëvara “Niagara” në Podgoricë. Vazhduan udhëtimin për në hotelin e rezervuar në qytet dhe mbrëmja i gjeti të hareshëm dhe miqësorë si rrallëherë. U rehatuan në hotel “Hilton” dhe u çlodhën e u argëtuan tek pishinat e tij. Të nesërmen autobusi mori rrugën drejt Kolashinës, ku luajtën me ski e slita derisa u lodhën, për të vazhduar më vonë me shëtitjet në natyrë dhe një vizitë në qendrën tregtare “Delta”. Ditën e kthimit radhën e kishte qyteti i bukur bregdetar i Budvës. Të gjitha vendet e vizituara ishin me të vërtetë disa prej mrekullive natyrore të Ballkanit dhe fëmijët u argëtuan dhe i shijuan shumë.





### ***Vajzat e klasave të 7-ta dhe të 8-ta në Mavrovë***

Nisja për në Mavrovë e vajzave të klasave të 7-ta e të 8-ta u organizua pas mësimit. Rreth orës 5 të pasdites arritën në hotel "Radika", aty ku nxënëset u akomoduan. Pamja e mrekullueshme e liqenit gjysmë të ngrirë, nën kurorat e pemëve gjetherënëse, si dhe shëtitjet me teleferik e bënë të paharrueshme këtë fundjavë shkurti në Mavrovë. Pas dy netëve qëndrimi erdhi dhe momenti i kthimit në Tiranë. Gjatë kthimit u bënë ndalesa në Ohër dhe nxënëset shëtitën në bregun e liqenit dhe në qendrën e qytetit, pa harruar edhe dhuratat për familjarët. Më pas ndalesa tjetër në qytetin e Strugës, ku dhe hëngrën një drekë me ushqime tradicionale të zonës.





## ***Udhëtimi i vajzave të klasave të 9-ta në Pejë***

Vajzat e klasave të 9-ta kaluan një fundjavë të këndshme në Pejë, në qytetin që u ofron vizitorëve ta shohin të kaluarën përmes traditave të tij dhe monumenteve kulturore. Akomodimi u bë në hotel “Dukagjini” dhe pasi pushuan pak në hotel vajzat vizituan Manastirin e Deçanit. Në ditën e dytë të udhëtimit ato u ngjitën në vendin malor e turistik të Bogës, ku pjesën më të madhe të ditës e kaluan në pistën e skive, duke u argëtuar mes bardhësisë dhe flokëve të borës. Ditën e tretë vajzat vizituan qytetin e Prizrenit dhe pasi bënë një shëtitje të shkurtër rreth tij, menduan të kalonin disa orë në një qendër tregtare. U kthyen në Tiranë me mbresa të bukura e të paharrueshme.



## ***Klasa e 7G në TEG***

Klasa e 7G zhvilloi një ekskursion në qendrën tregtare TEG. Nxënësit mbërritën atje në orarin e transmetimit të filmit “Aquaman”. Ishte një eksperiencë e bukur dhe zbavitëse. Pas filmit ata shëtitën nëpër qendër tregtare dhe shijuan disa nga ushqimet që pëlqyen. U kthyen në shkollë për të përfunduar orarin mësimor, por vazhdimisht mendonin për emocionet e këndshme që u dhuroi ky aktivitet në shoqërinë e mësueses dhe shokëve të klasës.





## ***Shëtitje në Durrës***

Nxënësit e klasës së 8D zhvilluan një ekskursion buzë bregdetit ranor të Durrësit. Pas arritjes në qytetin turistik, nxënësit bënë xhiro përgjatë shëtitores "Taulantia", ndërsa relaksoheshin dhe ndiheshin larg monotonisë së përditshme. Pasi arritën në fundin e shëtitores, nxënësit drekuan në një ambient të zgjedhur nga vetë ata. Bisedat e ndryshme me mësuesen dhe mes miqsh ishin plot të qeshura dhe i dhanë kënaqësi gjithë udhëtimit.

Gjatë një dite tjetër mësimore edhe nxënësit e klasës së 9H dhe të 9D kaluan pothuaj gjysmën e ditës buzë bregdetit të bukur të Durrësit. Ata bënë shëtitje në shëtitoren e Vollgës, ku dhe u argëtuan në ambientet piktoreske rreth e rrotull. Nxënësit mbetën të kënaqur nga kjo shëtitje, sepse ia kaluan mrekullueshëm në shoqërinë e njëri-tjetrit.





### ***Në bregdet me klasat e 7-ta***

Ishin pikërisht nxënësit e klasave të shtata që preferuan të kalojnë një ditë relaksuese jashtë mjedisit të shkollës. Për ta nuk mund të mungonte dëshira për të zgjedhur një qytet bregdetar si destinacionin e duhur pas provimeve. Durrësi, në harmoni me detin, kohën e bukur dhe entuziazmin e nxënësve, ishte qyteti që i tërhoqi nxënësit. Ftesa për të kaluar një ditë të veçantë erdhi nga familja e nxënësit tonë, Henri Çerenishti, shoqëruar me pritjen mbresëlënëse pranë Kompleksit "FAFA", në Durrës.

### ***Shëtitje në Itali me djemtë e klasave të 8-ta***

Djemtë e klasave të teta, të shoqëruar nga mësuesit e shkollës sonë, morën pjesë në shëtitjen që u organizua në Itali. Ata vizituan së pari qytetin e Milanos, ku dhe ndoqën ndeshjen e futbollit Inter-Juventus, si dhe vizituan shëtitoren "Piazza Duomo", galerinë "Vittorio Emanuele" dhe qendrën tregtare "Rinascente". Në Milano ata vizituan gjithashtu katedralen e njohur "Duomo di Milano", si dhe vende të tjera historike. Pas vizitës në Milano u nisën për në qytetin e mrekullueshëm të Veronas. U zbavitën në lojërat e parkut "Gardaland" dhe vizituan akuariumin përrallor "Sea Life Aquarium".

Eskursioni zgjati katër ditë dhe nxënësit tanë u argëtuan pafund. Kujtimet e kësaj shëtitjeje do t'u mbeten gjatë në kujtesë.



## ***Shëtitje në Korfuz me klasat e 4-ta e të 5-ta***



Shëtitja në Korfuz me klasat e katërta dhe të pesta ishte nga ato udhëtime që e bënë fundin e vitit shkollor edhe më të paharrueshëm. Udhëtimi me traget u shoqërua me fluturimin e albatrosëve e më pas na priste ishulli i njohur. Shëtitja nëpër kalanë e vjetër veneciane të ishullit na dhuroi disa orë të kaluara më së miri. Pamjet e mrekullueshme nga maja e kalasë, ku dukej rrethimi nga të gjitha anët me ujë dhe velat e anijeve si flutura të bardha përmbi det, ishin nga më të bukurat që mund të shohë syri i njeriut.

Përveç shëtitjes nëpër ishull, njohjen me historinë e tij, ecjen buzë detit, blerjet në tregun plot ngjyra dhe fotove të panumërta, nga ky udhëtim do të mbeten gjatë në mendjet e fëmijëve edhe gatimet e shijshme, larjet në pishinat e hotelit "Corfu Holiday Palace" dhe lojërat në hollin dhe ambientet e tjera të tij.







### ***Ekskursion në Shkodër me klasat e 3-ta***

Për t'u njohur më mirë me historinë dhe legjendat tona, për nxënësit e klasave të 3-ta u organizua një ekskursion në qytetin e bukur e mikpritës të Shkodrës. Kalaja e Shkodrës, një monument shumëshekullor, ishte pika turistike e vizituar nga këta nxënës. Nxënësit u njohën me historinë e kalasë dhe me legjendën e Rozafës. Një nga vendet më interesante e mbresëlënëse të kalasë ishte vendi në të cilin, sipas legjendës, është murosur Rozafa. Nxënësit u argëtuan në mjediset e saj dhe shijuan pamjet tërheqëse të natyrës dhe të lumit Buna. Nga bedenat e kalasë, shfaqej me gjithë madhështinë e tij, qyteti i bukur i Shkodrës. Dhe më pas, një drekë plot shije, e cila mbylli këtë vizitë mes bukurisë, mikpritjes dhe bujarisë shkodrane.

### ***“Festa e librit” me nxënësit e klasës së 4G***

“Festa e librit” titullohej projekti në lëndën e gjuhës shqipe, realizuar nga nxënësit e klasës së 4G. Me dëshirën e madhe për librin e leximin dhe me vetëdijen se dashuria për librin kultivohet që në fëmijëri, këta fëmijë zhvilluan një orë projekti në Teatrin e shkollës. Nxënësit ishin veshur si personazhi i zgjedhur dhe u prezantuan në skenë në lojë me role dhe ku nxënësit ishin piktori, skenaristi, regjizori dhe aktorët. Ata sollën edhe zbukurime dhe librat e tyre të preferuar, për të krijuar një atmosferë sa më të gëzueshme.





### Klasat e para në Festën e Abetares

Këngët e bukura për shkronjat dhe festën e abetares, vargjet e recituara me zërat e ëmbël që dridheshin herë-herë, kërcimet ritmike dhe veshjet e bardha të fëmijëve e mbushën skenën dhe sallën me një atmosferë të gëzueshme dhe plot gjallëri këto ditë maji. Këto festa ishin një festival i vërtetë shkronjash, tingujsh e ngjyrash, të cilat zbukuroheshin mes zërave të vogëlushëve. Duartrokitjet, buzëqeshjet, falenderimet dhe fotot plot gëzim në fund të festës ia shtonin ngjyrat ditës, e cila u buzëqeshte fëmijëve plot dashuri.



T  
S  
P





D

M

E

F

O

G



H

R

I



J

U



K

## ***Finalja e Kampionatit të Futbollit te klasat e 3-ta e të 4-ta***

Ndeshja finale e Kampionatit të Basketbollit për djemtë e klasave të 3-ta u zhvillua midis klasës së 3D dhe të 3E. Edhe pse të vegjël në moshë, midis nxënësve u realizua një ndeshje sportive mjaft e mirë. Kupën e kampionatit e fituan djemtë e klasës së 3E, me rezultatin e golave 4-3.

Ndërkohë një nga aktivitetet më emocionuese, me ndeshje nga më të fortat dhe me tifozët më të zjarrtë, ishte Kampionati i Futbollit për djemtë e klasave të 4-ta. Klasa e 4B, me shumë mund dhe me një bashkëpunim shumë të mirë të djemve mes njëri-tjetrit, ia doli të fitonte kupën.







### ***Kampionatet e Hendbollit dhe të Futbollit të klasat e 5-ta***

Pas ndeshjeve mes vajzave të klasave të pesta, në finalen e Kampionatit të Hendbollit arritën të dalin klasat e 5D dhe e 5G. Dhe mbas një ndeshjeje të fuqishme, në të cilën të gjitha nxënëset dhanë më të mirën e tyre, fitoren e mori klasa e 5D, me rezultatin 8-5.

Edhe ndeshjet e Kampionatit të Futbollit të këtij viti të klasat e pesta ishin mjaft konkurruese, por megjithëkëtë, e 5F dhe e 5G triumfuan mbi të tjerat dhe dolën në finale. Ethet e lojës kishin pushtuar këdo dhe megjithëse të dyja klasat luajtën bukur, klasa e 5G ishte ajo që mundi ta çonte kupën në shtëpi.



### ***Kampionati i Futbollit për klasat e 6-ta, të 7-ta e të 9-ta***

Ka përfunduar Kampionati i Futbollit për djemtë e klasave të 6-ta. Gjatë kësaj ndeshjeje nuk kanë munguar tifozët, pasi ato u gjendën aty, si gjithmonë, për të inkurajuar skuadrën e tyre. Në finale dolën klasa e 6D dhe klasa e 6G, ku fituese ishte klasa e 6D.

Në Kampionatin e Futbollit për klasat e 7-ta në finale dolën klasa e 7B dhe klasa e 7D. Pas një përballjeje emocionuese, titullin kampion e fitoi klasa e 7D, me rezultatin e golave 5-2.

Ndërsa te klasat e 9-ta në finale dolën skuadrat e së 9A dhe të 9C dhe pas një ndeshjeje shumë luftarake, triumfuese doli skuadra e klasës së 9C.







### ***Kampionati i Basketbollit te klasat e 8-ta e të 9-ta***

Ka përfunduar Kampionati i Basketbollit për vajzat e klasave të 8-ta. Në finale dolën klasat e 8D-8E. Vajzat luajtën me aq përkushtim, duke dhënë më të mirën e tyre në fushë. Ndeshja finale ishte shumë intensive dhe mbas një loje të fuqishme fitoren e mori klasa e 8E, me rezultatin 26-20 pikë.

Nga ana tjetër edhe ndeshja mes klasave e 9A dhe e 9F ishte e mbushur plot energji. Pas një konkurrence të fortë, Kampionati i Basketbollit për vajzat e klasave të 9-ta u finalizua me fitoren e klasës së 9A.



## Temat e kopshtit

### ***Një paradite në fermë me grupin “Frutat”***

Fëmijët e grupit të parë “Frutat” kaluan disa orë të këndshme gjatë vizitës në fermën e dietologes Blerina Bombaj Troci. Ata provuan të përgatitin vetë biskota, të mbjellin bimë dhe të ushqejnë kafshët e fermës. Minutat atje kaluan si pa i ndier dhe kur erdhi ora e drekës, e shijuan mes bisedave dhe gatimeve me shije të restorantit të fermës.



### ***Në Pezë me grupet e dyta të kopshtit***

Grupet e dyta të kopshtit “Zübeyde Hanım” u organizuan në një ekskursion mjaft gjallërues, mes gjelbërimit dhe ajrit të pastër të fshatit Pezë. Lojërat e ndryshme mes tyre dhe bashkë me mësueset, si dhe dreka e ngrënë në një ambient të hapur i lumturoi të vegjlit dhe u dhuroi ndjesi të paharrueshme.





### ***Vizita në familjet e shokëve***

Në përshtatje me temën mësimore “Familja ime”, grupet e dyta organizuan vizita në familjet e shokëve të grupit. Ishte dëshira e fëmijëve dhe e vetë prindërve që i ftuan, për t’i bërë këto vizita. Kjo është një traditë e bukur që bëhet prej vitesh në kopshtin “Zübeyde Hanım”, në vazhden e bashkëpunimit kopsht-familje. Mikpritje, bujari dhe dashuri morën këta fëmijë nga familjet që vizituan. Kjo shihej qartë në ushqimet e përgatitura me shumë dashuri dhe në sytë gazmorë të fëmijëve që u kënaqën pa masë.

### ***Fëmijët e parashkollorit me aplikacionin “Shtëpia”***

Për fëmijët e parashkollorit koha është gjithmonë e mbushur me projekte interesante, pasi edukimi më i rëndësishëm nis që në fëmijërinë e hershme. Projekti i radhës i grupit parashkollor “Lepurushët” ishte aplikacioni “Shtëpia”, gjatë të cilit fëmijët kanë bërë një fletëpalosje. Në fletëpalosje shfaqej një shtëpi me elemente nga shtëpia e tyre reale apo e imagjinuar.





## Ora e përrallës

Pasi fëmijët mbledhen përreth, zysha e përrallës rreshton mbi tavolinë personazhet e përrallës dhe ndërton mjedisin me ndërtesa e pemë, duke e vizualizuar përrallën për fëmijët e vegjël. Pasi mbaron përralla, tema e së cilës mund të jetë nga më të larmishmet, nis edhe diskutimi. Çdo fëmijë thotë mendimin e tij, pa u ndikuar aspak nga shokët, dhe shpalos personalitetin dhe ndjenjat e tij të veçanta. Diskutimi nis me moralin dhe vazhdon me personazhin kryesor, personazhin e tyre të preferuar dhe mesazhin kryesor të përrallës.

## Projekti “Trupi i pemës”

Fëmijët e parashkollorit kanë bërë një tjetër projekt që iu ka zgjuar kureshtjen. Projekti titullohej “Trupi i pemës”, projekt që përveç aftësive në pikturë, u mësoi fëmijëve dhe shumë gjëra të reja. Fëmijët kanë vizatuar në fletë një pemë me gjithë elementet e saj përbërëse. Tek pema ata emërtuan çdo pjesë, duke nisur që nga trugu, gjethet dhe rrënjët.



## Mësojmë shkronjën “T”

Mënyra më e mirë për të mësuar është duke u argëtuar. Ndaj dhe fëmijët e parashkollorit për t’u njohur me shkronjën e re, T-në, e kthyen orën e mësimi në një orë argëtimi. Ata prenë dhe ngjiten vetë letrat me ngjyra, duke krijuar kafshë si tigri, emri i të cilit fillon me T ose dhe ekranin e tyre preferuar, televizorin. Fëmijët ishin shumë të kënaqur me çfarë ata arritën të krijonin. Kushedi, mbase T-ja është tanimë shkronja e tyre e preferuar.



## Argëtohemi me projektin “Ferma e kafshëve”

Fëmijët e parashkollorit, përveç projekteve me shtëpitë moderne të qytetit, gjatë një ore mësimore kanë punuar për projektin me temë “Ferma e kafshëve”. Fëmijët, me ndihmën e mësueses, e kanë realizuar projektin edhe me mjete të riciklueshme. Ferma u krijua brenda një kutie kartoni. Atje ata ngjitën kafshë, shpendë dhe fermerët me traktorë. Me anë të shkopinjve të akulloreve bënë edhe gardhin që ndante kafshët nga shpendët. Ky projekt i ka ndihmuar fëmijët të zgjerojnë njohuritë, duke mësuar për mënyrat e ndryshme të jetesës së kafshëve. Gjithashtu ata mësuan emrat e të gjitha kafshëve dhe të shpendëve që qëndrojnë në një fermë dhe ndryshimin bazë mes një kafshe e një shpendi.

## Te këndi i lojërave prej druri

Në kopshtin “Zübeyde Hanım” ka shumë ambiente që janë në funksion të fëmijëve dhe njëri prej tyre është edhe këndi i lojërave prej druri. Në këtë ambient fëmijët luajnë dhe argëtohen, por njëkohësisht zhvillojnë imagjinatën dhe aftësitë krijuese, duke krijuar figura dhe forma të ndryshme. Ai është një nga këndet që fëmijët e dëshirojnë dhe ku luajnë me kënaqësi.



# Smile Concept & Face Aesthetics

## SHËRBIMET TONA:

Radiologji  
Stomatologji Konservative  
Endodonti  
Stomatologji Estetike  
Periodontologji  
Kirurgji Orale

Protetikë  
Implantologji  
Ortodonci  
Pedodonti  
Sedacion  
Anestezi Gjenerale  
Mjekësi Estetike e Fytyrës



Paraqituni me këtë kupon  
pranë klinikës sonë dhe do të përfitoni:



**Konsultë Falas**  
**20% Ulje**  
nga shërbimet tona.

Adresa: Rruga Myslym Shyri, Nr.80, Tiranë - Albania  
Kontakt: 068 81 81 888 / [www.estelitedentalcenter.al](http://www.estelitedentalcenter.al)



# Projekti "Drejt Evropës"

*"Drejt Evropës" një nga projektet më të bukura e origjinale, i cili reflekton jo vetëm kreativitetin, por edhe dëshirën e nxënësve tanë, sikundër dëshirënë gjithë shqiptarëve për ta parë Shqipërinë si gjithë Europa.*





# MAXX ROYAL

Rezervoni pushimet në 1 nga 10 resortet më të mira në botë  
ekskluzivisht me Globus Travel



GLOBUS TRAVEL  
Say Globus Think Travel



[www.globustravel.al](http://www.globustravel.al)

